



V E N D I M

Nr. 25 Datë 22. 02. 2008

PËR

**MOS FILLIMIN E PROCEDURAVE PER SHQYRTIMIN E KERKESES SE
SHOQERISE "WTS ENERGJI" SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 9, dhe nenit 19, të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike " i ndryshuar, Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 44, datë 24.07.2004, "Për Miratimin e Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s", neni 15 dhe 18, si dhe vendimit te Bordit te Komisionereve te ERE-s, Nr 21 date 04.042007, "Rregullorja e Proçedurave te Licensimit", neni 10, pika 2 dhe neni 15, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 22.02.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "WTS Energji" sh.p.k, për modifikimin e licenses per prodhimin e energjise elektrike me Nr. 16, seria PV04P, te mbajtur nga kjo shoqeri,

VENDOSI :

1. Mos fillimin e proçedurave për shqyrtimin e kërkesës, për modifikimin e liçenses me Nr. 16, seria PV04P, leshuar me vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s, Nr. 39 date 22. 07. 2004, per shoqerine "WTS Energji" sh.p.k.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit te Tregut si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, për pergatitjen e njoftimit per vendimin e dhene nga ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.